



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 1544/1 Prot.

Tiranë, më 2/03/2021

URDHËR

Nr. 143, Datë 12.03.2021

**“PËR  
HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT, NOTERIT  
LUIZ EJLLI”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të nenit 21, pika 1 gërma “ë” të ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”,

**KONSTATOJ:**

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 384, datë 16.11.2020, “Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë noterit Luiz Ejlli”, është ushtruar kontroll në zyrën noteriale të noterit Luiz Ejlli, i cili e ushtron veprimtarinë e tij në Bashkinë Tiranë.

Referuar Urdhrit nr.384, datë 16.11.2020, në datë 19.11.2020, grupi i kontrollit u paraqit në adresën e deklaruar, “*Rruga Jordan Misja, Pallati 141, Shk.2, Kati 1, Njësia Bashkiake nr. 9, Tiranë*”, për ushtrimin e veprimtarisë noteriale.

Nga verifikimet, rezultoi se zyra noteriale e deklaruar nga noter Luiz Ejlli, për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, nuk u gjend.

Në vijim, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, në datë 18.12.2020, është dërguar një e-mail drejtuar noterit Luiz Ejlli, duke e njoftuar mbi paraqitjen e grupit të punës pranë zyrës së tij noteriale me qëllim realizimin e inspektimit, sipas Urdhrit të Ministrit, si dhe në lidhje me vendodhjen e ushtrimit të aktivitetit notarial, ku në përputhje me pikën 4, të nenit 17, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se, “*Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, në rastet e ndryshimit të vendodhjes së zyrës noteriale ose të dhënave të tjera të shënuara në Regjistrin e Noterisë noteri osë zëvendësnoteri njoftojnë me shkrim Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën brenda 15 ditëve nga fillimi i veprimtarisë në adresën e re ose ndryshimit të fakteve të përfshira në Regjistrin e Noterisë*”. Nga ana e noterit Luiz Ejlli nuk është përcjellë asnjë përgjigje në lidhje me këtë fakt.

Gjithashtu, nga verifikimi në Regjistrin Tregtar, mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se, në ekstraktin historik se noteri Luiz Ejlli është me status aktiv nga data 09.09.2013 deri në datën 19.11.2020, me adresë ushtrimi i veprimtarisë në Njësinë Bashkiake nr.9, Rruga Jordan Misja, Pallati nr.141, Shk nr.2, Kati 1, Tiranë.

Nga verifikimi i realizuar në Regjistrin Noterial Shqiptar nuk rezulton që ky noter të ketë regjistruar akte noteriale nga data 04.05.2018.

Komunikimet zyrtare me shërbimin postar në adresën e deklaruar nga noteri, konkretisht: "*Rruga Jordan Misja, Pallati 141, Shk.2, Kati 1, Njësia Bashkiake nr. 9, Tiranë*", kanë patur pamundësi dërgimi. Zarf i përcjellë së bashku me njoftimin e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.384, datë 16.11.2020, në datë 19.11.2020, për ushtrimin e kontrollit në adresën e deklaruar nga noter Luiz Ejlli, për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, është kthyer nga shërbimi postar, me shënimin "*Larguar*".

Në vijim, me shkresën nr.7460/2 Prot., datë 03.12.2020, "*Kërkesë për Bashkëpunim*", Ministria e Drejtësisë i është drejtuar Degës Vendore të Noterisë, Tiranë duke njoftuar mbi: "*Kryerjen e inspektimit të Përgjithshëm ndaj noterit Luiz Ejlli*" dhe duke kërkuar nga ana e kësaj Dhome caktimin e një përfaqësuesi nga ana e saj për kryerjen e një inspektimi të dytë në adresën e deklaruar nga ana e këtij noteri. Më datë 30.12.2020 grupi i inspektimit së bashku me përfaqësuesin e Degës Vendore të Noterisë Tiranë janë paraqitur në adresën e deklaruar "*Rruga Jordan Misja, Pallati 141, Shk.2, Kati 1, Njësia Bashkiake nr. 9, Tiranë*". Nga verifikimet, rezultoi se zyra noteriale e deklaruar nga noter Luiz Ejlli, për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, nuk u gjend.

Nga verifikimi në RNSH, fakti që nga noteri nuk është ushtruar veprimtari noteriale mbi 60 ditë, në mënyrë të përsëritur provohet nga verifikimi në Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH), ku pasqyrohet veprimtaria e mëposhtme:

- Për vitin 2018, ka kryer vetëm 195 akte/veprime noteriale, për periudhën 03.01.2018-04.05.2018. Këto të dhëna vërtetojnë faktin se nga noteri janë kryer veprime deri në maj 2018, ndërkohë nuk ka afruar shërbim për 7 muajt e tjerë të vitit 2018.
- Për vitin 2019, *nuk ka kryer veprime noteriale*, për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019. Këto të dhëna vërtetojnë faktin se nga noteri nuk janë kryer veprime për vitin 2019 pra nuk ka ofruar shërbim për këtë vit.
- Për vitin 2020, *nuk ka kryer veprime noteriale*, për periudhën 01.01.2020 - 19.11.2020. Këto të dhëna vërtetojnë faktin se nga noteri nuk janë kryer veprime për vitin 2020, pra nuk ka ofruar shërbim për këtë vit.

Referuar veprimet të fundit të realizuar nga noteri Luiz Ejlli në RNSH, nr.137, datë 04.05.2018, konstatohet se noteri ka mbi dy vite që nuk ofron shërbim ndaj qytetarëve, pa shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Gjithashtu, grupi i punës konstatoi se zyra e noterit nuk gjendej në adresën e deklaruar, ku sipas pikës 4, të nenit 17, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se, “Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, në rastet e ndryshimit të vendndodhjes së zyrës noteriale ose të dhënave të tjera të shënuara në Regjistrin e Noterisë, noteri ose zëvendësnoteri njoftojnë me shkrim Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën brenda 15 ditëve nga fillimi i veprimtarisë në adresën e re ose ndryshimit të fakteve të përfshira në Regjistrin e Noterisë”.

Në vijim, nga ana e Sektorit të Arkiv-Protokollit, është realizuar njoftimi se Raporti me gjetjet respektive, drejtuar noterit Luiz Ejlli, është kthyer nga ana e Postës Shqiptare me shënimin “larguar”. Me shkresën nr.62/3 Prot., datë 19.01.2021, i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare, me qëllim marrjen e informacionit nëse Raporti i përpiluar dhe i dërguar pranë noterit Luiz Ejlli, ka mbërritur në destinacion (pasi ishte dërguar dhe në adresën e vendbanimit të noterit). Nga ana e Postës Shqiptare, me shkresën nr.62/4 Prot., datë 26.01.2021 jemi njoftuar se, zarfi drejtuar noterit, në adresën e deklaruar, është kthyer me shënimin “larguar”. Gjithashtu, raporti i dërguar në adresën e dytë, atë të vendbanimit, është marrë nga znj.Edona Ramadani. Nga ana e noterit nuk është përcjellë qendrim zyrtar mbi gjetjet e raportit.

Në këto kushte, Noteri Luiz Ejlli, nuk ka ushtruar aktivitetin e profesionit të noterit në respektim të tagrave deleguar nga Ministri i Drejtësisë dhe kuadrit ligjor në fuqi, në cilësinë e një funksioni që ka karakter publik, kundrejt shërbimeve ndaj personave fizikë dhe juridikë, sipas përcaktimeve të nenit 3/c dhe nenit 4 të Ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, ku sanksionohet se:

c) “Noter” është personi fizik i licencuar nga Ministri i Drejtësisë për kryerjen e veprimtarisë noteriale brenda territorit të një bashkie të caktuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. “Profesioni i noterit në Republikën e Shqipërisë është një funksion i pavarur, me karakter publik, në shërbim të personave fizikë dhe juridikë, i cili ushtrohet nëpërmjet hartimit të akteve juridike dhe ushtrimit të veprimtarive noteriale të tjera, të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.”

Rezulton se, noteri Luiz Ejlli nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara në nenin 63, pika 1, gërma “m” ku citohet se, “Noteri, përveç detyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në ligje të veçanta, kryen detyrat e mëposhtme...siguron mbajtjen hapur të zyrës noteriale, sipas rregullave të miratuara për këtë qëllim”. Gjithashtu, në pikën 3, të këtij neni, parashikohet se, “Për raste të tjera, kur noteri nuk ka zëvendës dhe mungon më tepër sesa 10 ditë, ai lajmëron me shkrim Dhomën, nga e cila merr konfirmimin e njoftimit”. Në këto kushte, vlerësohet se jemi në kushtet e braktisjes së detyrës nga ana e noterit Luiz Ejlli.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 1, gërma “ë” të nenit 21, të ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, parashikohet se: “Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri... nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohe deri në 60 ditë rresht pa shkak të arsyeshem, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë”.

## URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Luiz Ejlli, anëtar i Degës Vendore të Noterisë Tiranë, pasi nuk ushtron veprimtarisë noteriale për një peirudhë kohe mbi dy vite pa shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
  - a) Znj. Ina Papa, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
  - b) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë, brenda 7 ditëve nga marrja dijani e këtij Urdhri;
  - c) Një përfaqësues i caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.
3. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit Luiz Ejlli, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij Urdhri .
4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Bankat e nivelit të dytë.
5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
6. Dega Vendore e Noterisë Tiranë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 7 ditëve nga marrja dijani e këtij Urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”.
7. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 6, të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit të përcaktuar nga Dega Vendore përkatëse e Noterisë, brenda 10 ditëve pune.
8. Ndaj këtij urdhri, noteri mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.
9. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.
10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore e Noterisë Tiranë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

11. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij Urdhri noterit Luiz Ejlli dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI  
  
Etilda Gjona (Saliu)

